



Prishtinë: 02.09.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1383\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2206\_07\_21** i dt. 15.07.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 03.08.2021;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F.K “Mulliri Prapashticë IL” nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2206\_07\_21, i datës 15.07.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 15.07.2021 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2206\_07\_21 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit F.K. “Mulliri Prapashticë IL” nga Komuna e Prishtinës lidhur me mos aktivizimin e shifrës DPE – 9023965 dhe ndërrimin e njehsorit elektrik, për shkak të moskryesjes në trafostacionin e mëhershëm.

I pakënaqur me vendimin e DMK-së, konsumatori F.K (Ankesa e parashtruar nga Bashkim Jakup Dibrani), brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Nëse trafo ka qenë private, përse punëtorët e KEDS-it janë futur në pronë private dhe e kanë hapur trafon, ku pas atij momenti trafo është djegur;
- Punëtorët e KEDS-it kanë deklaruar se trafo është djegur aksidentalisht dhe se do të bëjnë përpjekje që ta ndërrojnë;
- Konsumatori është regjistruar nga viti 2012 dhe i ka paguar të gjitha shërbimet e KEDS-it, dhe nëse konsiderohet si kyçje ilegale, përse i është lejuar kyçja dhe faturimi?
- Konsumatori kërkon që të rregullohet kyçja, dhe t’u mundësohet zhvillimi i veprimtarisë së tyre.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Në pretendimin se përse punëtorët e KEDS-it janë futur në pronë private, meqë trafo nuk është pronë e KEDS-it, Bordi thekson se punëtorët fillimisht nuk kanë pasur mundësi që ta kenë një informacion të tillë, e me të pranuar kërkesën për zëvendësimin e trafos, të njëjtit kanë dal në vendin ku gjendet trafoja, andaj, nuk ka asgjë për t'u kontestuar në këtë drejtim.

Siç edhe është konstatuar në vendimin e DMK-së dhe nga shkresat e lëndës, Bordi ka konstatuar këtë gjendje faktike:

Me datë 14.07.2020 dhe me datë 14.01.2021 Konsumatori Ferid Kadriu (Mulliri Prapashticë) me shifër DPR - 2000798 ka bërë kërkesë zyrtare në KEDS dhe KESCO për zëvendësimin e trafos, pasi sipas konsumatorit trafoja ku furnizohet konsumatori është djegur dhe se KEDS duhet të bëjë zëvendësimin e trafos pasi që ai është aset i KEDS-it. Bazuar në kërkesën e konsumatorit, punëtorët e autorizuar të KEDS-it për verifikimin e dëmit me datë 11.12.2020 kanë inspektuar vendin e ngjarjes së konsumatorit dhe se sipas konsumatorit është theksuar se komisioni pas vizitës në teren ka konstatuar se konsumatori ka trafon e vet private 50 kVA e cila është në shtyllë, ormanin e ka në shtyllë dhe njehsorin të cilat janë djegur. Ormani i shpërndarjes 0.4kV dhe transformatori duhet në rregull nga ana e jashtme mirëpo ka rezultuar e djegur pasi që e ka qitur dalja nga tensioni dhe tani është e shkyçur në tension 10 kV.

**Provë:** Ankesa/Kërkesa e konsumatorit dhe Procesverbali për verifikimin e dëmit nr.0001843 e datës 11.12.2020

Me datë 07.07.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS kanë dalur te konsumatori dhe kanë evidentuar se: TS Keqekoll, Prapashtica te Famovit, kemi grupo 1 grop për shtyll (2m e kemi ngjit), kemi kontrollu edhe trafon e Mullirit, i kemi hjek kabllat prej trafos e kemi provu në të zbrazët dhe prapë e qet dalja dhe i djeg 3 siguresat e trafos, si dhe e kish djeg edhe ormanin.

**Provë:** Leja e punës e datës 07.07.2020

Me datë 02.04.2021 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën/kërkesën e tij. Në përgjigjen e KESCO lëshuar konsumatorit është theksuar trafoja e cila furnizon objektin tuaj është aset privat dhe KEDS nuk ka të drejtë të operoj mbi asetet të cilat nuk i ka nën kontroll dhe në pronësi të vet, pra nuk ka të drejtë të intervenimit apo zëvendësimit të trafos. Gjithashtu KEDS ka theksuar se sipas procedurave të kyçjes konsumatori mund të parashtron kërkesë për kyçje dhe pastaj KEDS do ta trajtoj sipas procedurave, rregullave përkatëse dhe konform zgjidhjeve teknike të ofruara nga KEDS. Pra sipas përgjigjes së KESCO dhënë konsumatorit vërehet se KESCO/KEDS kanë evidentuar se trafoja e cila furnizon objektin tuaj është aset privat dhe nuk është aset i KEDS, dhe si i tillë KEDS nuk ka përgjegjësi për ndërrimin/zëvendësimin e aseteve private, si dhe është potencuar se sipas procedurave dhe rregullave për kyçje, konsumatori mund të paraqes kërkesë për kyçje dhe sipas zgjidhjeve teknike të ofruara nga KEDS do të trajtohet sipas rregullave në fuqi.

**Provë:** Përgjigja e KESCO-s e datës 07.12.2017

Konsumatori ka siguruar Pëlqimin Elektroenergjetike nr.2516 të datë 27.04.1988 në të cilën theksohet Mulliri Elektrik i Prapashticës me fuqi prej 36 kVA ka këtë zgjidhje teknike të kyçjes, ku kyçja do të bëhet me kabëll nëntokësor nga Trafostacioni në shtyllë dhe i cili gjendet pranë objektit. Gjithashtu



konsumatori ka siguruar edhe një kontratë nr.2513 të datës 27.04.1988 ku përveç tjerash theksohet se pas ndërtimit të objektit elektroenergetik dhe plotësimit të kushteve të parapara nga pëlqimi elektroenergetik, ndërmarrja “Elektrokosova” do të regjistrojë në librat e veta afariste dhe ta mbaj në evidencë si mjet themelor.

**Provë:** Pëlqimi Elektroenergetik nr.2516 e datë 27.04.1988 dhe kontrata nr.2513 e datës 27.04.1988

Lidhur me ankesën e konsumatorit se aset nuk privat por i KEDS, ZRRE i është drejtuar KEDS-it për informata shtesë, duke kërkuar informata lidhur me ankesën e konsumatorit, respektivisht se aset (trafoja) a është i regjistruar si aset i KEDS, si dhe informata tjera relevante me rastin. KEDS me datë 27.04.2021 i është përgjigjur DMK në ZRRE duke theksuar se në bazë të informatave që kemi pranuar figuron se aset është privat dhe i njëjti nuk është regjistruar në regjistrin e aseteve të OSSH-së, dhe se OSSH nuk ka arritur të siguroj ndonjë dokument përmes se cilit dëshmon se është bërë pranimi teknik i trafos në fjalë, rrjedhimisht edhe në skemat njëpolëshe të trashëguara nga KEK, ky aset (trafo) figuron si trafo private pa kod, që nënkupton se trafoja nuk posedon pranim teknik. Në përgjigje KEDS ka theksuar se trafoja gjendet në oborrin e konsumatorit dhe i ka shërbyer ekskluzivisht vetëm konsumatorit në fjalë, dhe se KEDS si operator i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes nuk ka nën menaxhim të vetin trafo që i shërbejnë vetëm një konsumatori, e për më shumë KEDS për mirëmbajtje asnjëherë nuk e ka pasur këtë trafo në listën e aseteve për mirëmbajtje. KEDS në përgjigjen e tyre kanë theksuar se në CCP konsumatori me shifër DPR – 2000798 figuron i regjistruar që nga viti 2006 dhe atë përmes faturimit për rikthimin e humbjeve si faturë e parë, që nënkupton se KEK si operator i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes ka vërejtur se konsumatori është duke shfrytëzuar energji elektrike në mënyrë të paautorizuar dhe i njëjti është regjistruar në kodin e trafos më të afërt në pronësi të KEK-ut të nivelit 0.4kV me shifër TS 1401600404300 prej nga furnizohen plot 27 konsumatorë të tjerë, në mënyrë që konsumatori të mund të faturohet. KEDS në përgjigjen e dhënë ZRRE-së ka theksuar se trafoja gjendet në oborrin e konsumatorin dhe fillimisht i ka shërbyer ekskluzivisht vetëm konsumatorit në fjalë, dhe se konform informatave të pranuar nga tereni në TS e Mullirit është evidentuar si i kyçur edhe konsumatori Bashkim Jakup Dibrani me shifër DPR 90079212, i cili gjithashtu në sistemin e OSSH-së figuron i kyçur në TS i cili është djegur. Përderisa konsumatori me shifër DPR - 2000798 nuk ka qenë shpenzues i energjisë elektrike muajve të fundit, konsumatori me shifër DPR - 90079212 kishte furnizim nga ky TS dhe i njëjti mund të dëshmohej nga transaksionet që ka pas shpenzim (dëshmi që posedon një rikthim të humbjeve). Për më tepër, pas djegës së aseteve edhe konsumatori me shifër DPR 90079212 është i faturuar me tarifë fikse që nënkupton se nuk ka furnizim me energji elektrike. Konsumatori në CCP është i regjistruar në kodin e trafos e KEDS-it me qëllim të faturimit të rikthimit të humbjeve dhe faturimit të shpenzimeve të energjisë elektrike, e që trafoja e KEDS është e energjizuar dhe shfrytëzohet edhe nga konsumatorë të tjerë.

**Provë:** Shkresa e ZRRE dhe përgjigja e KEDS

Sipas analizave të bëra transaksioneve të konsumatorit me shifër DPR – 2000798, vërehet se kjo shifër për herë të parë është regjistruar si konsumator me datë 12.12.2006 përmes faturës nr.DPR06HP01522, e që nënkupton shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve), dhe se fatura e parë e energjisë elektrike është regjistruar pa shpenzim, por vetëm taksa. Nga kjo mund të konstatojmë se regjistrimi i shifrës DPR – 2000798 përmes faturës së rikthimit të



humbjeve rezulton se kyçja në rrjetin elektrik ka ndodhur pa autorizim të punëtorëve të KEK (atëkohë), si dhe nga transaksionet e konsumatorit rezulton se shifra DPR – 2000798 është regjistruar në emër të Mulliri Prapashticë Reduktor 200/5 IL. F.K, ku duhet potencuar se shprehja IL nënkupton se është konsumator ilegal, pra kyçje në rrjetin elektrik pa u plotësuar kushtet teknike të përcaktuara në kodet teknike. Gjithashtu sipas informatave të pranuar nga KEDS dhe dokumenteve të pranuar, në atë trafo është e kyçur edhe shifra DPR - 90079212 nga viti 2012 dhe se është e regjistruar në emër të Bashkim Jakup Dibrani.

**Provë:** Transaksionet e konsumatorit të shifrës DPR – 2000798 dhe DPR - 90079212

ZRRE ka analizuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO si dhe shkresat tjera të lëndës dhe konstaton se konsumatori me shifër DPR – 2000798 për herë të parë është regjistruar si konsumator me datë 12.12.2006 përmes faturës nr.DPR06HP01522, e që nënkupton shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve), pra kyçje e konsumatorit në rrjetin elektrik është bërë pa autorizim të punëtorëve të KEK (atëkohë). Duhet theksuar se konform përgjigjeve të dhëna nga KEDS, theksohet qartë se trafota ku është i kyçur objekti i konsumatorit është aset privat dhe si të tillë KEDS nuk e posedon këtë trafo në librat themelorë të aseteve të tyre, andaj edhe zëvendësimi i trafos nuk është përgjegjësi e KEDS. Gjithashtu duhet potencuar se sipas shkresave të lëndës vërehet se në skemat njëpolëshe (skema elektrike të rrjetit të OSSH) të trashëguara nga KEK, ky aset figuron si trafo private pa kod, që nënkupton se trafota nuk posedon pranim teknik. Pra bazuar në shkresat e lëndës vërehet se trafota ku është i kyçur konsumatori është aset privat dhe se nuk figuron në librat themelorë të KEDS si aset i tyre. Sa i përket çështjes së ngritur nga konsumatori lidhur me atë se pse kanë hyrë punëtorët e KEDS në pronën ku është trafota nëse ka qenë aset privat, DMK në ZRRE ju thekson se KEDS përveç tjerash menaxhon dhe operon edhe me rrjetin 10kV, dhe se edhe në atë dokument nuk është theksuar se punëtorët e autorizuar të KEDS kanë bërë ndonjë ndërrim të ndonjë pajisje përveç se kanë konstatuar gjendjen e trafos. Ndërsa sa i përket dokumenteve të siguruar nga konsumatori si Pëlqimi Elektronenergjetik nr.2516 i datës 27.04.1988 dhe kontrata nr.2513 e datës 27.04.1988, vlen të theksohet se konsumatori nuk ka arritur të na sigurojë ndonjë dokument se është bërë pranimi teknik i trafos dhe pajisjeve tjera, në mënyrë që ato asete sipas kontratës të kalonin te KEK atëkohë.

Në nenin 28, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Ligjit për Energjinë Elektrike, thuhet se: ofrimi i kyçjeve në rrjetin e shpërndarjes në pajtim me këtë ligj, për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit që kërkojnë një lidhje të tillë, në pajtim me kërkesat për kyçje të përcaktuara në Kodin e rrjetit të shpërndarjes. Në nenin 54, paragrafi 4, të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe në nenin 10, paragrafi 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, theksohet se: Operatori i Sistemit mund të refuzoj të kyçë një aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi”. Duhet theksuar se KEDS nuk ka refuzuar kyçjen e konsumatorit por i ka potencuar që duhet konsumatori të bëjë aplikimin për kyçje në rrjetin elektrik sipas dispozitave të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, t’i plotësoj kushtet teknike sipas dispozitave ligjore të Kodit të Shpërndarjes dhe Kodit të Matjes, pasi sipas KEDS konsumatori asnjëherë nuk ka pasur pranim teknik nga ana e KEK (atëkohë) dhe tani KEDS.

Në nenin 4.5.3.6 të Kodit të Shpërndarjes thuhet se: “Pronësia përkatëse e stabilimentit apo aparateve duhet të regjistrohet në një marrëveshje të shkruar në mes OSSH-së dhe Shfrytëzuesit apo në formë të



diagramit, sipas kërkesës. Në mungesë të marrëveshjes së veçantë në mes palëve, përgjegjësitë mbi ndërtimin, kontrollimin, operimin dhe mirëmbajtjen, caktohen sipas kushteve preliminare të kufirit të pronësisë”. Duhet theksuar se në rastin e konsumatorit nuk ka ndonjë marrëveshje të shkruar në mes të OSSH dhe shfrytëzuesit (konsumatorit) lidhur me pronësinë përkatëse të stabilimenteve, pasi që nuk ka dokument mbi pranimin teknik të pajisjeve elektrike.

Në nenin 7 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se: “Për mirëmbajtjen e kyçjeve që janë në pronësi të konsumatorëve, operatorët e sistemit do të ngarkojnë konsumatorët në mënyrë të vazhdueshme sipas çmimores së miratuar nga Rregullatori, dhe me tarifa të cilat do të mund të rregullohen në mënyrë të përshtatshme. Mirëmbajtja e kyçjes përfshinë mirëmbajtjen e kablove/përçuesve të lidhur në rrjetin e operatorit, aparaturat matëse dhe siguresat hyrëse (nëse aplikohen) të kutive matëse. Kjo do të mund të kryhet vetëm nga operatorët e sistemit të Transmetimit ose Shpërndarjes”. Në nenin 8 të Rregullës në fjalë, thuhet se: “Konsumatorët që kanë në pronësi të tyre pika kyçjeje, përfshirë aparaturat matëse, mund t’i transferojnë asetet e tyre tek operatorët e sistemit pa asnjë kompensim pas sjelljes së tyre në gjendje të rregullt siç kërkohet në kodet teknike të nxjerra nga operatorët e sistemit dhe miratuar nga Rregullatori. Prej datës kur do të bëhet transferimi i këtyre asetëve nga konsumatorët, do të aplikohen dispozitat e paragrafi 5 të këtij neni. Asetet e transferuara do të përfshihen në bazën e asetëve të operatorit të sistemit që shfrytëzohet për qëllimet e miratimit të tarifave të rregulluara nga Rregullatori, në përputhje me parimet e përcaktuara në Metodologjitë e Tarifave.”

Në nenin 9 dhe shtojcën 1 të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të shpërndarjes, janë të përcaktuara edhe parimet e rregullimit të kostove e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes.

Bazuar në të gjitha shkresat e lëndës Bordi i ZRRE konstaton se trafoja nuk është aset i KEDS, pra nuk është i regjistruar në librat themelor të KEDS dhe si të tillë KEDS nuk mund të bëjë zëvendësimin e trafos. Gjithashtu Bordi thekson se KEDS nuk ka refuzuar kyçjen e konsumatorit në rrjetin elektrik, por ka kërkuar që konsumatori të aplikoj në rrjetin elektrik, sipas rregullave dhe procedurave në fuqi dhe të ipen kushtet teknike të kyçjes sipas Kodeve teknike, dhe pastaj pas plotësimit të kushteve teknike nga ana e konsumatorit, atëherë KEDS duhet të bëjë pranimin teknik të pajisjeve elektrike, dhe pastaj bëhet edhe kyçje në rrjetin elektrik.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët ankesën e konsumatorit, ankesa/kërkesën e konsumatorit, Procesverbalin për verifikimin e dëmit nr.0001843 të datës 11.12.2020, Leja e punës e KEDS e datës 07.07.2020, Pëlqimin Elektroenergjetik nr.2516 e datë 27.04.1988 dhe kontratën nr.2513 e datës 27.04.1988, Korrespondencat e KEDS dhe ZRRE, transaksionet e konsumatorit të shifrës DPR – 2000798 dhe DPR-90079212, dispozitat ligjore të Ligjit për Energjinë Elektrike, Rregullës për Kushtet e përgjithshme të Furnizimit me Energji, Kodi i Shpërndarjes, ka vendosur si në dispozitivin për këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit F.K. (B.D.) dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar